Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija
Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

NJOFTIM PËR SHTYRJE TË AFATIT TË FTESËS PUBLIKE PËR PJESËMARRJE NË FORUMIN EKONOMIK KOSOVË – POLONI

Data e mbajtjes: 18 nëntor 2026
Vendi: Prishtinë
Lokacioni: Hotel Hilton

Me qëllim të promovimit të investimeve dhe eksporteve, si dhe të zhvillimit të ndërmarrjeve vendore, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), fton bizneset e Republikës së Kosovës të shprehin interesimin për pjesëmarrje në **Forumin Ekonomik Kosovë–Poloni**, i cili do të mbahet më 18 nëntor 2026, në Prishtinë.

Forumi organizohet nga MINTI/KIESA, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës-MPJD, përkatësisht Ambasadën e RKS-së në Poloni dhe Departamentin për Diplomaci Ekonomike(MPJD, me synim forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit ndërmjet Kosovës dhe Polonisë.

Një fokus i veçantë i forumit do t'u kushtohet takimeve të drejtpërdrejta ndërmjet bizneseve (B2B), me qëllim të identifikimit të mundësive për partneritete dhe bashkëpunim konkret në sektorët vijues:

1. **Qeverisja digjitale dhe ekonomia digjitale;**
2. **Teknologjitë e mbrojtjes, sigurisë dhe sigurisë kibernetike;**
3. **Prodhimi i avancuar, infrastruktura dhe energjia.**

Dokumentet e nevojshme për aplikim

Bizneset e interesuara duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
2. Aplikacionin e plotësuar, me të dhënat bazë të biznesit dhe informacionet lidhur me aktivitetin, produktet ose shërbimet dhe interesimin për bashkëpunim me kompani nga Polonia;
3. Kopjen e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit të autorizuar të biznesit, nëse kërkohet për qëllime të verifikimit të aplikimit.

Mënyra dhe afati i aplikimit

Dokumentet e kërkuara duhet të dërgohen në mënyrë elektronike në adresën **invest.kiesa@rks-gov.net**, më së voni deri më **6 nëntor 2026, në orën 23:59**.

Me subjekt: Aplikim për pjesëmarrje në forumin ekonomik Kosovë – Poloni

Përzgjedhja e bizneseve do të bëhet duke marrë parasysh përputhjen e veprimtarisë së tyre me sektorët e forumit dhe potencialin për bashkëpunim me kompanitë pjesëmarrëse nga Polonia.

Për informata shtesë, mund të kontaktoni në numrin: **+383 (38) 200 36 530**.

MINISTRIA E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË, TREGTISË DHE INOVACIONIT